

COMBAT HP

ADITIV HIGJENIZUES ME PERFORMANCË TË LARTË- SPECIFIK PËR VESHJE (GRAFIATO),
BOJRA MURALE ANTIMYK ANTIALGA PËR SIPËRFAQE TË JASHTME
SERI 481

PËRSHKRIMI

COMBAT HP është një produkt i formuluar posaçërisht për tu shtuar në finiturat (Grafiato,bojra) murale antimyk antialga, nën markën San Marco dhe përdoret për mbrojtjen e sipërfaqeve murale të jashtme.

Formulimi I veçantë krijon një aksion sinergjik (bashkëpunimi) me bojra dhe veshje murale antimyk-antialga, duke rritur performancën dhe duke siguruar ruajtjen e pamjes origjinale estetike. Rekomandohet gjithashtu të përdoret edhe në kushte të pafavorshme, siç janë zonat klimatike veçanërisht të lagështa dhe me shi, prania e madhe e sporeve të kërpudhave, veshjet termike Cappotto (edhe në ekspozim kritik).

DOZA: 1 litër aditiv në 25 Kg. ose 15 l. bojë ose veshje murale antimyk / antialga.

UDHËZIME PËR PËRDORIM

Destinacionet e përdorimit të COMBAT HP janë ekskluzivisht bojrat dhe veshjet (Grafiato) antimyk antialga për sipërfaqe të jashtme.

Mos e përdorni në finitura MARCOTHERM-SYL pasi performanca e tij është optimale. Nuk përdoret në produkte të privuara nga mbrojtja kundra mykut dhe algave.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

- Tretësi: ujë.
- Dendësia UNI EN ISO 2811-1: 1,14 ± 0,05 kg/l.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

UDHËZIMET E APLIKIMIT

- Tundni produktin para se ta shtoni në bojë.
- Shtoni COMBAT HP ne raportin 1 liter aditiv në 25 kg ose 15 lt bojë.
- Pastrimi I mjeteve bëhet menjëherë pas përdorimit, me ujë.

NGJYROSJA

MAGAZINIMI

Temperatura maks. e ruajtjes: +30 °C
Temperatura min. e ruajtjes: +5 °C
Produkti preferohet të përdoret deri në 2 vjet pas datës së prodhimit nëse është ruajtur në ambalazhin origjinal të pahapur dhe në kushtet e temperaturës adekuate.

TË DHËNA MBI SIGURINË

Nuk bën pjesë në D. Lgs 161/2006 (Dir.2004/42/CE).
Shtimi I COMBAT HP në sasi të e parashikuara modifikon etiketimin për rrezikun të produktit ku shtohet. Mund të shkaktojë reaksion alergjik të lekurës. Toksik për organizmat ujorë në periudhë afatgjatë. Produkti duhet të transportohet, përdoret dhe të mbahet stok sipas normave aktuale të higjienës dhe sigurisë. Pas përdorimit mos I hidhni ambalazhet në ambient,I lini të thahen dhe I trajtoni si mbetje të veçanta. Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

SPECIFIKIMET

SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperiencia e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti I produktit. Skeda e paraqitur anullon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.